

RREGULLORE PËR PROFILET E STANDARTIZUARA TË NGARKESËS

Miratuar me Vendimin e Bordi të ERE nr.. XXX, datë XX.XX.XXXX.

Neni 1

Këto rregulla janë përgatitur sipas Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 69, gërma f; 86 , pika 6, dhe në përputhje me Rregullat për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE.

Neni 2

Qëllimi

Këto rregulla janë hartuar për të siguruar që Neni 86(6) lidhur me kushtet teknike për Klientet Fundore që ata të kalojnë tek një treg i liberalizuar dhe neni 69 lidhur me profilet e standardizuara të ngarkesës të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Nr. 43/2015, i ndryshuar në Shkurt 2018, me ligjin Nr. 7/2018 mund të aplikohet në një mënyrë e cila përputhet me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe mundëson hapjen e tregut me pakicë dhe që klientët të ndryshojnë furnizuesit përmes një kuadri të zbatueshëm rregullator.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Këto rregulla vendosin:
 - a. proçedurat sipas të cilave OSSH duhet të hartojë dhe implementojë profilet e standardizuara të ngarkesës që do të përdoren për çdo kategori Klientesh Fundor për të cilët matja, e cila mat konsumin real në intervale nuk është e disponueshme; dhe
 - b. kriteret në baze të të cilit OSSH ushtron zgjedhjen e saj në lidhje me përmbushjen e kushteve teknike për klientët që ata të jenë të aftë të ndryshojnë furnizuesin e tyre në treg të liberalizuar.
2. Këto rregulla mbulojnë marrëdhënien midis OSSH dhe furnizuesve të cilët furnizojn Klientin Fundor sipas një profili të standartizuar të ngarkesës.

Neni 4

Perkufizimet

1. Termat e përdorur por që nuk përcaktohen tek këto rregulla kanë perkufizimin që është dhënë për ato tek Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike.
2. Profilet e konsumit, reale apo të standartizuara, janë konsumi i energjisë elektrike për çdo kategori klientsh gjatë ditës, të përfaqësuar nga një furnizues, të cilat aplikohen për shlyerjen e disbalancave.

3. Profili i konsumit real paraqitet me anë të një diagrame e cila përshkruan profilin e konsumit aktual të energjisë elektrike, sipas treguesve të sistemit të matjes të instaluar tek pika e marrjes së konsumatorit.
4. Profili i standartizuar i ngarkesës supozohet si një profil intervali ditor konsumi hartuar nga OSSH për çdo kategori klientësh (si përshkruhen tek këto rregulla) të cilat nuk kanë një sistem matje që mundëson regjistrimin e konsumit të vërtetë.
5. Profili i standartizuar i ngarkesës përfaqëson ngarkesën tek një pjesë intervali të barabartë ose më të ulët se periudha e shlyerjes së disbalancimit
6. Profilet e Standartizuara të Ngarkesës zëvendësojnë profilet e konsumit real për përgjegjësinë e balancimit sipas mekanizmit për shlyerjen e disbalancave, për çdo periudhë gjatë të cilës matja e cila mat konsumin real në intervale nuk është e disponueshme.

Neni 5

Kriteret për vlerësimin e kushteve teknike të sistemeve të matjes

1. Sipas Nenit 86, paragrafi 6, OSSH duhet të shikojë nëse sistemi i matjes i klientit që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit përmbush kushtet teknike për tu lejuar klientëve të furnizohen në pjesën e lirë dhe të liberalizuar të tregut.
2. Kriteri sipas të cilit OSSH do të vlerësojë kushtet teknike të sistemit të matjes duhet të jenë jo-diskriminuese, objektive, të thjeshta dhe të qarta dhe nuk duhet të çenojnë detyrimet e OSSH për ofrimin e aksesit jo-diskriminues në rrjetin e shpërndarjes. Po ashtu kriteret duhet të sigurojnë që të gjithë klientët mund të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtën e tyre për të zgjedhur.
3. OSSH do të vlerësojë kushtet teknike dhe do të ushtrojë zgjedhjen e saj ndaj kriterëve të mëposhtme:
 - a. Klienti është një Klient Fundor me sistem matje të regjistruar tek OSSH me adresë pikën e marrjes.
 - b. Klienti regjistrohet tek Sistemi Gjeografik i Informacionit që aplikohet nga OSSH nëpërmjet furnizuesit.
 - c. Klienti furnizohet dhe faturohet për konsumin e tij të energjisë elektrike bazuar tek vlerat e matura si lexohen nga sistemi matës, përfshirë nëse është e aplikueshme korrigjime periodike të mëvonshme.
 - d. OSSH ka akses në sistemin e matjes për të siguruar lexim periodik të matësit.
4. Vlerësimi i kushteve teknike siç përcaktuar në Nenin 86, paragrafi 6, do të kufizohet për kriteret e përmendura në paragrafin 3 të këtij Neni.
5. Sistemi inteligjent i matjes preferohet por nuk është para-kusht për një klienti i cili ndryshon furnizuesin dhe nuk përbën një kriter për OSSH për të konfirmuar aftësinë e klientit për tu furnizuar nëpërmjet një furnizuesi në treg të liberalizuar.

Neni 6

Të drejtat e kleintëve

1. FSHU/FMFdo të informojë të gjithë Klientet Fundore te saj, nëpërmjet një teksti të miratuar nga ERE dhe të përfshirë tek faturat e klientit edhe/ose me ane te medias, për të drejtën e tyre për të ndryshuar furnizimin e tyre me energji elektrike nga furnizues i shërbimit universal ose furnizues i mundësisë së fundit tek një furnizues alternativ.
2. Në rastin kur një klient nuk i përmbush kushtet teknike, si përcaktohet në Nenin 5, paragrafi 3, OSSH do të japë informacion për atë klient sipas kriterit ndaj të cilit janë vlerësuar kushtet teknike në Nenin 4, paragrafi 3. Tek të gjitha rastet e tjera, konsiderohet që klientët duhet të përmbushin kushtet për të ndryshuar furnizuesin pa kushte të tjera.
3. Informacioni i ofruar sipas paragrafit 2 të këtij Neni duhet të përfshijë çdo informacion të veçantë që klienti duhet të ofrojë për të lehtësuar procesin.

Neni 7

Profilet e standardizuara të ngarkesës

1. OSSH do të krijojë profile të standardizuara të ngarkesës për të gjitha kategoritë e klienteve në rastin kur të dhënat e kërkuara të matjes për shlyerjen e disbalancës nuk janë në dispozicion nga sistemi i matjes i klientit.
2. Për të shmangur dyshimet, nëse periudha e vendosur për disbalancat është çdo orë, profili i standardizuar i ngarkesës duhet të jetë të paktën në intervale një orëshe. Nëse profili i standardizuar i ngarkesës është i ndarë në segmente më të vogla se një orë, të dhënat duhet të vendosen në intervale një orëshe.

Neni 8

Krijimi i profileve të standardizuara të ngarkesës

1. OSSH duhet të krijojë profile të standardizuara të ngarkesës bazuar në dy kriteret të përgjithshme:
 - a. Kategoria e klientve
 - b. Zona Administrative ku është i vendosur klienti.
2. klientet të cilët i përkasin një kategorie kanë të njëjtat karakteristika dhe për shlyerjen e disbalancave, konsumi i tyre i energjisë elektrike standartizohet për një profil ngarkese të veçantë.
3. Për disa kategori klientesh kriteri zonës mund të merret në konsideratë.
4. Profili i Standardizuar i ngarkesës për çdo kategori klientesh do të vendoset nga OSSH për një periudhë prej të paktën një vit kalendarik.
5. Profili i Standartizuar i ngarkesës për çdo kategori klientesh për çdo vit kalendarik do të publikohet të paktën tre muaj para fillimit të vitit tek faqja e OSSH.
6. Para publikimit të profileve të standartizuara të ngarkesës, OSSH do të konsultohet me pjesëmarrësit e tregut, ERE dhe palët e tjera të interesuara .

Neni 9

Kategoritë e klientve

1. OSSH duhet të përgatisë profile të standartizuara të ngarkesës për kategoritë e mëposhtme të Kliente Fundore që janë lidhur në rrjetin e saj:
 - a. Biznese si supermarket, furra buke, restorante , etj.
 - b. Teknologjite e larta siç janë njësitë e mesme të prodhimit.
 - c. Teknologjite e ulëta siç janë rrobaqepsitë, njësitë e vogla të prodhimit, zdrukthtaritë, etj.
 - d. Bizneset ditore siç janë pikat e pakicës, dyqanet e vogla.
 - e. Restorantet, baret, klubet e natës, kazinot etj.
 - f. Konsumatorët familjare në qytet
 - g. Konsumatorët familjare në fshat
 - h. Ndriçimi publik
 - i. Ndërtesat publike, shkollat, universitetet, etj.

Neni 10

Forma e profileve

1. Profilet e ngarkesës duhet të përgatiten në formë tabelash ku të përfshihet numri i orëve gjatë ditës dhe raportet korresponduese të cilat tregojnë marrëdhënien midis konsumit gjatë asaj ore dhe konsumin ditor.

Neni 11

Afati kohor

1. Profili fillestar i standardizuar i ngarkesës për të gjitha kategoritë e Klienteve Fundore që janë të lidhur në rrjetin e OSSH dhe të specifikuar në këto rregulla duhet të përgatiten dhe paraqiten për rishikim dhe miratim në ERE nga OSSH brenda dy muajve pasi këto rregulla kanë hyrë në fuqi. Profile të tilla do të aplikohen gjatë periudhës deri në fund të vitit kalendarik periudhë në të cilën ato miratohen nga ERE, përveç kur ky miratim të jetë më vonë se data 30 Shtator, rast në të cilin profilet aplikohen deri në përfundim të vitit tjetër kalendarik..dhe një draft për vitin tjetër kalendarik Brenda 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave, OSSH do të fillojë të mbledhë të dhënat e konsumit nga matësat smart të instaluar , ose do të aplikojë disa pajisje të tjera të përshtatshme matëse të cilat lejojnë grumbullimin e të dhënave që kanë lidhje me profilet reale të ngarkesës në lidhje me të gjitha kategoritë e klienteve
2. Bazuar tek matjet, profilet aktuale të ngarkesës duhet të përditësohen në përfundim të çdo viti dhe duhet të aplikohet për ti pastruar llogaritjet gjatë vitit në vazhdim ose:
3. Bazuar tek matjet, profilet aktuale të ngarkesës duhet të përditësohen rregullisht.
4. Deri në arrijtjen e një ndarje minimale prej 2% të klienteve brenda secilës kategori klientsh konsumi i të cilëve monitorohet për këte qëllim, profilet e ngarkesës duhet të përditësohen çdo vit. Në atë masë që të arrihet ndarja minimale prej 2% e klientve të vëzhguar, përditesimet e profileve duhet të kryhen minimumi çdo pesë vjet.

Neni 12

Aksesi i te dhenave te matjes

1. OSSH ka akses në sistemin e matjes për të siguruar lexim periodik të matësit me perjashtim te leximeve te matesave te klienteve te lidhur ne rrjetin e saj ,por te furnizuar nga Furnizuesit.
- 2.
3. OSSH duhet te kete akses ne sistemin e matjes per te siguruar lexim periodik te matesave te Klienteve Fundore te lidhur ne rrjetin e saj, por te furnizuar nga Furnizuesit.
4. Operatori i Sistemit te Transmetimit OST duhet te ofroje akses ne te dhenat e matesave te klientve qe ajo administron sipas Nenit 3, pika 3.4 temarveshjes dy paleshe midis OST dhe OSSH dt.28.12.2017.

Neni 13 hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi ne Janar 2021 .

DRAFT